

LIGJ
Nr.10 364, datë 16.12.2010

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 “PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8/1 “Të ardhura të përjashtuara”, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:
“8. Kontributet e bëra nga punëdhënësi për sigurimin e jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve.”.

Neni 2

Në fund të nenit 20 “Shpenzime të njohura” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
“Shpenzimet e sigurimit të jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve nga punëdhënësi konsiderohen si shpenzime të njohura.”.

Neni 3

Neni 25 “Rezervat speciale për bankat dhe shoqëritë e sigurimit” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

Rezervat speciale për bankat dhe shoqëritë e sigurimit

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të bankave dhe të shoqërive të sigurimit janë shpenzime të njohura rezervat teknike, të krijuara në përputhje me ligjin “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe provizionet e bankave, të krijuara në përputhje me standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare dhe të certifikuara pa vërejtje nga auditues të jashtëm, por, në çdo rast, pa tejkaluar masën e përcaktuar në rregullat e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim. Shumat e rimarra nga këto rezerva apo provizione i shtohen fitimit të tatueshëm.”.

Neni 4

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Pjesëmarrjet që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të një personi rezident përjashtohen, si të ardhura, dividendët dhe ndarjet e fitimit, kur ato shpërndahen nga shoqëritë e ortakëritë rezidente dhe

shoqëritë jorezidente të huaja, që janë subjekte të tatimit mbi fitimin, pavarësisht nga kuota e pjesëmarrjes, në vlerë ose në numër, të kapitalit aksionar, të së drejtës së votës apo të pjesëmarrjes në kapitalin fillestar apo aksionar të përfituesit.”.

Neni 5

Në nenin 30 “Parapagimet”, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, gjatë periudhës tatimore, vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të vendosura nga Ministria e Financave. Në rast se subjekti taksapagues ka ulur kështu e parapagimit, të caktuara nga organi tatimor, dhe detyrimi tatimor vjetor për tatimfitimin, që rezulton nga bilanci, tejkalon parapagimin me më shumë se 10 për qind, subjekti duhet të paguajë interes mbi diferencën ndërmjet detyrimit real vjetor dhe shumës së parapaguar gjatë vitit, sipas rregullave të vendosura nga Ministria e Financave.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6837, datë 5.1.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**